



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 53**

**Qershor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Aktnormativ nr.1, datë 9.6.2006	Për njohjen e Republikës së Malit të Zi .....	3
Vendim i KM nr.600, datë 31.8.2006	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa, S.p.A. për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës” .....	3
Vendim i KM nr.615, datë 7.9.2006	Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidatëve për anëtarë të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare .....	4
Vendim i KM nr.617, datë 7.9.2006	Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore .....	4
Vendim i KM nr.638, datë 20.9.2006	Për kontributin e Qeverisë Shqiptare në ngritjen e Ushtrisë Kombëtare Afgane dhe Ushtrisë Kombëtare Irakene, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit .....	6
Vendim i KM nr.646, datë 27.9.2006	Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për përballimin e shpenzimeve për veprimtaritë ndërkombëtare, që do të organizohen në kuadër të presidencës shqiptare të nismës së Europës Qendrore NEQ/CEI.....	6
Vendim i KM nr.649, datë 27.9.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Fadil Hasa...	7

Vendim i KM nr.650, datë 27.9.2006	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zonjës Evgjëni Kote .....	8
Vendim i KM nr.652, datë 27.9.2006	Për një shtesë fondi disa njësive të qeverisjes vendore, për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, si dhe për marrjen e masave për parandalimin e emergjencave civile .....	8
Vendim i KM nr.653, datë 27.9.2006	Për lejimin e Kryeministrit të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me shoqërinë “Ridge Global Llc”, për dhënie shërbim konsulence, për hartimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kombëtare, mirëqeverisjen, mbështetjen për anëtarësimin në Nato dhe luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe kriminalitetit .....	10
Vendim i KM nr.661, datë 4.10. 2006	Për autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të lidhë marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Crans Montana Forum” .....	11
Vendim i KM nr.686, datë 11.10.2006	Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e ardhshme të organeve të qeverisjes vendore .....	11
Vendim i KM nr.711, datë 18.10.2006	Për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të njësive të qeverisjes vendore .....	13
Vendim i KM nr.721, datë 25.10.2006	Për dhënie ndihme financiare disa familjeve të dëmtuara, respektivisht, nga tërmetet e datave 6 e 8 gusht 2006 dhe 13 qershor 2006, në bashkitë e komunat e qarqeve, Vlorë e Gjirokastër .....	15
Vendim i KM nr.724, datë 1.11.2006	Për lirim dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Kompanisë Teatrorë Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar) .....	24
Vendim i KM nr.731, datë 1.11.2006	Për miratimin e studimit “Për mundësinë e ndërtimit të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe të infrastrukturës përkatëse, në bregdetin e qarkut të Fierit” .....	24
Vendim i KM nr.737, datë 1.11.2006	Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve, në institucionet arsimore publike .....	25
Vendim i KM nr.749, datë 9.11.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet nr.39, datë 26.1.2001, nr.158, datë 22.3.2001, nr.167, datë 30.3.2001, nr.174, datë 30.3.2001, nr.197, datë 6.4.2001, nr.358, datë 31.5.2001, dhe nr.424, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar .....	31

Vendim i KM  
nr.750, datë 9.11.2006

Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.198,datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pranimet në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2006-2007, në sistemin me kohë të plotë, dhe për përcaktimin e tarifës së shkollimit, në sistemin me kohë të plotë”, të ndryshuar ..... 32

**AKTNORMATIV  
Nr.1, datë 9.6.2006**

**PËR NJOHJEN E REPUBLIKËS SË MALIT TË ZI**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Njohjen e Republikës së Malit të Zi.

Neni 2

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM  
Nr.600, datë 31.8.2006**

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES FINANCIARE, NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E FINANCIVE, DHE ARTIGIANCASSA, SPA PËR FINANCIMIN E  
PROGRAMIT “FUQIZIMI I QENDRËS TRAUMATOLOGJIKE KOMBËTARE TË  
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes financiare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Artigiancassa, S.p.A, për financimin e programit “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, me një hua në shumën 5 000 000 (pesë milionë) euro.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.615, datë 7.9.2006**

**PËR PROPOZIMIN KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË KANDIDATËVE  
PËR ANËTARË TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për anëtarë të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të kandidatëve, si më poshtë vijon:

- |                            |   |
|----------------------------|---|
| - Elisabeta (Semini) Gjoni | Kryetare;   |
| - Keler Gjika              | Nënkryetar, drejtues i Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit;     |
| - Ermela Guxholli          | Nënkryetare, drejtuese e Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit; |
| - Miranda Ramaj            | Anëtare;  |
| - Diana Lamani             | Anëtare.  |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.617, datë 7.9.2006**

**PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË VLERËSIMIT DHE TË MONITORIMIT TË  
PROGRAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS PËR PERSONAT ME  
AFTËSI TË KUFIZUAR DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pika 4 e 31 shkronjat “g” e “gj” të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Monitorimi dhe vlerësimi i programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe i shërbimeve shoqërore realizohen në nivel vendor e kombëtar dhe kanë për qëllim:

- monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave, të masave e veprimeve, në zbatim të legjisllacionit, strategjive dhe programeve të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, rezidenciale apo komunitare, të ofruara nga persona juridikë, publikë dhe privatë;
- vlerësimin e efektivitetit të përdorimit të fondeve, në zbatim të politikave dhe programeve të mbrojtjes shoqërore;
- vlerësimin e ndikimit të politikave në uljen e varfërisë, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta;
- hartimin e rekomandimeve dhe të politikave për mbështetjen e grupeve në nevojë.

2. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, nëpërmjet strukturave që ka në varësi, grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore, si dhe harton raporte në fushën e ndihmës e të shërbimeve shoqërore, për:

- përcaktimin e nevojave për shërbime për grupet në nevojë të popullsisë;
- përcaktimin e familjeve të varfëra dhe të individëve, që kanë nevojë të mbështeten me pagesë në “cash” apo me shërbime shoqërore;
- përcaktimin e numrit dhe të shërbimeve shoqërore, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në nivel qarku, në bashki dhe komuna;
- vlerësimin e nevojave për shërbime të reja, në përputhje me kërkesat dhe burimet për ngritjen e tyre.

3. Bashkitë/komunat, çdo dy muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, hartojnë dhe dërgojnë në drejtorinë rajonale të shërbimit social shtetëror të dhëna statistikore për gjendjen e familjeve, që përfitojnë ndihmë ekonomike, për numrin e familjeve përfituese, numrin e personave me aftësi të kufizuar, që mbështeten me pagesë, si dhe për fondet e përdorura, sipas modularit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Bashkitë/komunat, çdo katër muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, hartojnë dhe dërgojnë në drejtorinë rajonale të shërbimit social shtetëror të dhëna statistikore për numrin dhe llojet e shërbimeve, që ofrohen nga personat juridikë, publikë dhe privatë, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe për nevojat për shërbime të reja të përkujdesjes shoqërore, sipas modularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Personat juridikë, publikë dhe privatë, dhe organizatat jofitimprurëse të licencuara sipas vendimit nr.564, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, në përfundim të çdo 4-mujori, brenda datës 10 të muajit pasardhës, të dërgojnë në bashkinë/komunën, ku ofrojnë shërbimet, si dhe në drejtorinë rajonale të shërbimit social shtetëror të dhëna statistikore për shërbimet e ofruara, sipas modularit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror, çdo katër muaj, vlerëson, përpunon dhe standardizon të dhënat e grumbulluara nga bashkitë/komunat, sipas pikave 3, 4 e 5 të këtij vendimi, dhe ia dërgon, sipas afateve të përcaktuara në këtë vendim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social dhe Shtetëror.

7. Bashkitë/komunat, personat juridikë, publikë dhe privatë, e organizatat jofitimprurëse, që ofrojnë shërbime shoqërore, i dërgojnë një kopje të raportit të të dhënave, çdo katër muaj, sektorit të shërbimeve shoqërore në qark, në përputhje me vendimin nr.563, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përgjegjësisë së qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”.

8. Drejtoria rajonale e shërbimit social shtetëror, nëpërmjet aktmarrëveshjeve të veçanta, vendos marrëdhënie bashkëpunimi për shkëmbimin e të dhënave statistikore, periodike, me zyrat e punësimit, zyrën e statistikës, zyrat e sigurimeve shoqërore, drejtoritë arsimore dhe ato shëndetësore në rrethe, sektorin e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark (SAMT), zyrën e regjistrimit të pronave dhe të automjeteve, si dhe me institucione të tjera, që veprojnë në nivel qarku.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e grumbulluara dhe të përpunuara në përputhje me standardet e përcaktuara me udhëzim të ministrit, i dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, e cila i përpunon ato për realizimin e qëllimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

10. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin për mënyrën e paraqitjes së të dhënave statistikore, nga strukturat përgjegjëse, sipas këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.638, datë 20.9.2006**

**PËR KONTRIBUTIN E QEVERISË SHQIPTARE NË NGRITJEN E USHTRISË  
KOMBËTARE AFGANE DHE USHTRISË KOMBËTARE IRAKENE, NË KUADËR TË  
PËRPPJEKJEVE TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI;

1. Heqjen nga armatimi i forcave të armatosura të municioneve, sipas llojeve, tipeve dhe sasive, të përcaktuara në pasqyrën “A”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Municionet e hequra nga armatimi, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të shërbejnë si kontribut i Qeverisë Shqiptare për ngritjen e Ushtrisë Kombëtare Afgane dhe Ushtrisë Kombëtare Irakene, në kuadër të përpjekjeve të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.
  3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Pasqyra A

<b>Emërtimi i municionit</b>	<b>Shteti prodhues</b>	<b>Koha e prodhimit</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pesha</b>
Fishekë 7.62x54 mm të zakonshëm	Kina	1965-1970	500.000 copë	10.5 ton
Predha 82 mm mortaje	Kina	1970-1972	2000 copë	10 ton
<b>Shuma</b>			<b>502 000</b>	<b>20.5 ton</b>

**VENDIM**  
**Nr.646, datë 27.9.2006**

**PËR NJË SHITESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2006, MIRATUAR PËR  
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, MINISTRINË E  
PUNËVE TË JASHTME DHE DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR  
PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR VEPRIMTARITË NDËRKOMBËTARE, QË DO  
TË ORGANIZOHEN NË KUADËR TË PRESIDENCËS SHQIPTARE TË NISMËS SË  
EUROPËS QENDRORE NEQ/CEI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2006, miratuar për ministritë dhe institucionet e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të shtohet fondi prej 55 350 000 (pesëdhjetë e pesë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për zhvillimin e veprimtarive ndërkombëtare, që do të organizohen në Tiranë, në periudhën shtator-nëntor 2006, në kuadër të presidencës shqiptare të Nismës së Europës Qendrore NEQ/CEL.

2. Ky fond të ndahet, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës t'i shtohet fondi prej 12 300 000 (dymbëdhjetë milionë e treqind mijë) lekësh, për organizimin e SEF (Summit Economic Forum) dhe të takimit të ministrave të ekonomisë të vendeve anëtare të NEQ/CEI;

b) Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare t'i shtohet fondi prej 6 150 000 (gjashtë milionë e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për disa riparime të shpejta në Pallatin e Brigadave;

c) Ministrisë së Punëve të Jashtme t'i shtohet fondi prej 36 900 000 (tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind mijë) lekësh, për realizimin e veprimtarive të Këshillit të Ministrave, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në kuadër të Nismës së Europës Qendrore NEQ/CEL.

3. Për përgatitjen dhe organizimin e këtyre veprimtarive, me urdhër të Kryeministrit, të ngrihet sekretariati i presidencës shqiptare të Nismës së Europës Qendrore.

4. Fondi prej 55 350 000 (pesëdhjetë e pesë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, pranë Këshillit të Ministrave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

## VENDIM Nr.649, datë 27.9.2006

### PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. FADIL HASA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Fadil Hasa, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.650, datë 27.9.2006**

**PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR**  
**ZONJËS EVGJENI KOTE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zonjës Evgjëni Kote, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.652, datë 27.9.2006**

**PËR NJË SHITESË FONDI DISA NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR**  
**REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË DËMTUAR NGA FATKEQËSITË**  
**NATYRORE, SI DHE PËR MARRJEN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E**  
**EMERGJENCAVE CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 12, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, dhe të neneve 31 e 32/a të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Njësive të mëposhtme të qeverisjes vendore, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’u shtohet fondi, si më poshtë vijon:

- Bashkisë Selenicë, të qarkut të Vlorës, për riparimin e argjinaturës së kanalit të madh, dëmtuar nga përmytjet e datës 1-2 dhjetor 2005, 3 000 000 (tre milionë) lekë;

- Bashkisë Delvinë, të qarkut të Vlorës, për rikonstruksionin e Urës së Kasapajve, në lagjen “9 tetori”, 3 000 000 (tre milionë) lekë;

- Bashkisë Gjirokastrë, të qarkut të Gjirokastrës, për sistemimin e përroit të Gjokanës dhe për marrjen e masave mbrojtëse nga gërryerjet, në lagjen e manëve, 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekë;

- Komunës Petran, të qarkut të Gjirokastrës, për marrjen e masave mbrojtëse nga rënia e masivëve shkëmborë në fshatrat Petran, Badelonjë dhe Gjinkar, 1 000 000 (një milion) lekë;

- Komunës Çarçovë, të qarkut të Gjirokastrës, për marrjen e masave mbrojtëse e parandaluese nga rënia e masivëve shkëmborë në fshatin Zhepë, 1 000 000 (një milionë) lekë;

- Komunës Antigone, të qarkut të Gjirokastrës, për rikonstruksionin e urës së Aznakut, 290 000 (dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë;

- Bashkisë Berat, 5 300 000 (pesë milionë e treqind mijë) lekë, nga të cilat:

- për mbrojtjen nga përmbytjet të brigjeve të lumit Osum, që shtrihen përgjatë qytetit Berat, 4 000 000 (katër milionë) lekë;
- për studimin gjeologjik dhe mbrojtjen emergjente të lagjes Goricë nga rrëshqitja e gurëve masivë 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë;
- Bashkisë Çorovodë, të qarkut të Beratit, për rikonstruksionin e urës mbi lumin Osum, 7 000 000 (shtatë milionë) lekë;
- Komunës Bogovë, të qarkut të Beratit, për sistemimin e përroit të Bogovës, 400 000 (këtrëqind mijë) lekë;
- Ndërmarrjes të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, të këshillit të qarkut të Kukësit, 9 000 000 (nëntë milionë) lekë, nga të cilat:
  - për riparimin e këmbëve të urës së Surrojit, 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë ;
  - për riparimin e këmbëve të urës së Bushtricës, të dëmtuara gjatë reshjeve të fundit, 3 000 000 (tre milionë) lekë.
  - Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale Tropojë, të këshillit të qarkut të Kukësit, për rikonstruksionin e rrugës automobilistike Dushaj-Kalatë, 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë;
  - Komunës Ujmisht, të qarkut të Kukësit, për riparimin e rrugës komunare të Ujmishtit, 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekë;
  - Komunës Topojan, të qarkut të Kukësit, për riparimin e rrugës, që lidh rrugën kombëtare me komunën, 5 000 000 (pesë milionë) lekë;
  - Komunës Fierzë, të qarkut të Kukësit, 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, nga të cilat:
    - për rikonstruksionin e rrugës T'Pla-Degë, 1 900 000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë;
    - për rikonstruksionin e rrugës Breg-Lumi (Kishë-Pepkolaj) 1 600 000 (një milionë e gjashtëqind mijë) lekë;
    - Komunës Blinisht, të qarkut të Lezhës, për mbrojtjen e brigjeve të përroit të Troshanit, 1 000 000 (një milion) lekë;
    - Bashkisë Lezhë, të qarkut të Lezhës, për fazën e pestë të mbrojtjes nga rrëshqitja e tokës, në lagjen Shehër, 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekë;
    - Bashkisë Krujë, të qarkut të Durrësit, për mbrojtjen nga rrëshqitja e tokës, në lagjet Kasmë dhe Perlat, 8 000 000 (tetë milionë) lekë;
    - Komunës Levan, të qarkut të Fierit, për riparimin dhe çbllokimin e kolektorit të ujërave të bardha, të fshatit Ferras, 700 000 (shtatëqind mijë) lekë;
    - Komunës Karbunarë, të qarkut të Fierit, për rikonstruksionin e urës, në fshatin Karbunarë dhe të urës, në fshatin Zgjanë, 2 900 000 (dy milionë e nëntëqind mijë) lekë;
    - Bashkisë Librazhd, të qarkut të Elbasanit, për rikonstruksionin e murit mbajtës, në lagjen Shesë, 4 000 000 (katër milionë) lekë;
    - Ndërmarrjes të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale, të këshillit të qarkut të Elbasanit, për rikonstruksionin e urës së fshatit Rapun-Kuturman, 4 000 000 (katër milionë) lekë;
    - Komunës Stravaj, të qarkut të Elbasanit, për sistemimin dhe marrjen e masave mbrojtëse për përroit, në zonën e banimit Qendër-Sharrë, 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;
    - Komunës Luzni, të qarkut të Dibrës, për sistemimin e përroit Mere, 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë;
  - Komunës Gur i Zi, të qarkut të Shkodrës, për sistemimin e përroit të Pistallit, në lagjet Gjonadej dhe Corraj, 5 000 000 (pesë milionë) lekë;
  - Komunës Shkrel, të qarkut të Shkodrës, për marrjen e masave mbrojtëse për përroit në komunën Shkrel, 5 000 000 (pesë milionë) lekë;
  - Komunës Bërdicë, të qarkut të Shkodrës, 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekë, nga të cilat:
    - për rikonstruksionin e rrugës Mali Hebe-Bërdicë, 900 000 (nëntëqind mijë) lekë;
    - për riparimin e rrugës Bërdicë e Mesme, 900 000 (nëntëqind mijë) lekë;
    - për riparimin e rrugës në Trush, 300 000 (treqind mijë) lekë;

- Komunës Hudënisht, të qarkut të Korçës, për mbrojtjen e rrëshqitjes së tokës, në fshatin Mëmëlisht, lagjia Pera, 2 000 000 (dy milionë) lekë;

- Këshillit të qarkut të Korçës, për rikonstruksionin e urës, në fshatin Lekas, 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

- Komunës Pirg, të qarkut të Korçës, për mbrojtjen e rrëshqitjes së tokës, në fshatin Pirg dhe devijimin e ujësjellësit të fshatit, 3 000 000 (tre milionë) lekë;

- Njësisë bashkiake nr.11, Tiranë, për rikonstruksionin e rrugës “Vangjel Noti” dhe për marrjen e masave mbrojtëse në kanalin e ujërave të ndotura, Kodër- Kamëz, 2 000 000 (dy milionë) lekë;

- Komunës Paskuqan, të qarkut të Tiranës, për marrjen e masave mbrojtëse për rrëshqitjen e tokës, në fshatin Kodër e Kuqe, 2 000 000 (dy milionë) lekë.

2. Fondi prej 117 990 000 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefektët e qarqeve përkatëse dhe organet e njësisë të qeverisjes vendore, të përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.653, datë 27.9.2006**

**PËR LEJIMIN E KRYEMINISTRISË TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, ME SHOQËRINË “RIDGE GLOBAL LLC”, PËR DHËNIE SHËRBIM KONSULENCE, PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMBËTARE, MIRËQEVERISJEN, MBËSHTETJEN PËR ANËTARËSIMIN NË NATO DHE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT, PASTRIMIT TË PARAVE DHE KRIMINALITETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 5 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të neneve 2 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Kryeministrisë, që, për fondin limit prej 46 608 000 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetë mijë) lekësh, të përdorë procedurën “prokurim i drejtpërdrejtë“, me shoqërinë “Ridge Global LLC”, për dhënie shërbim konsulence, për hartimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kombëtare, mirëqeverisjen, mbështetjen për anëtarësimin në NATO dhe luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe kriminalitetit, sipas termave të referencës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’i shtohet fondi prej 15 536 000 (pesëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe pjesa e mbetur të parashikohet në buxhetin e vitit 2007.

4. Shpenzimet e udhëtimit nga/dhe në Republikën e Shqipërisë të konsulentëve të huaj, të përzgjedhur nga shoqëria konsulente, të përballohen nga buxheti i Kryeministrisë, miratuar për vitin 2006.

5. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.661, datë 4.10. 2006**

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
TË LIDHË MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE “CRANS MONTANA FORUM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 19 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të lidhë marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “Crans Montana Forum”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.686, datë 11.10.2006**

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT QENDROR TË  
ZGJEDHJEVE, PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME TË ORGANEVE TË QEVERISJES  
VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e memorandumit të bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet zëvendëskryeministri, që, në emër të Këshillit të Ministrave, të nënshkruajë këtë memorandum, si dhe të ndjekë zbatimin e të drejtave dhe të detyrimeve, që përcaktohen në të.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI  
PËR ZGJEDHJET E ARDHSHME PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

*Meqenëse* së afërmi do të zhvillohen zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;

*Meqenëse* Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Kodi Zgjedhor ngarkon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me detyrën për të përgatitur, mbikëqyrur, drejtuar dhe verifikuar të gjitha aspektet, që kanë të bëjnë me zgjedhjet;

*Meqenëse* Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në zbatim të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar në fuqi dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, është seriozisht i angazhuar për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

*Meqenëse* për realizimin e këtyre standardeve kërkohet bashkëpunim serioz dhe i vazhdueshëm ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe strukturave shtetërore, në varësi të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;

*Duke marrë parasysh* rëndësinë e madhe, që kanë këto zgjedhje për të ardhmen e vendit dhe në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian;

*Si dhe për të realizuar*, në shkallë institucionale, këtë bashkëpunim,

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar si Këshilli i Ministrave) dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (më poshtë referuar si KQZ), nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi.

Palët nënshkruese të këtij memorandumit veprojnë në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor dhe legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Ministrave merr përsipër dhe i garanton KQZ-së:

- Nëpërmjet Ministrit të Financave:

-Financimin e procesit zgjedhor sipas kërkesave të KQZ-së, në mbështetje të legjislacionit në fuqi, për Buxhetin e Shtetit dhe procedurat e shpenzimeve buxhetore.

-Nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë:

-Krijimin e lehtësive në lëshimin e vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të kërkuar nga subjektet politike apo individë, në funksion të plotësimit të dokumentacionit ligjor, për efekte zgjedhore.

-Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, gatishmërinë e gjykatave të shkallës së parë në gjykimin e shpejtë të ankesave të zgjedhësve për përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve.

-Nëpërmjet Ministrit të Brendshëm:

-Asistencë për sigurimin e mjediseve për zyrat e KZQV-ve, të mjediseve për vendet e numërimit të votave dhe KQV-të;

-Asistencë për sigurimin e mjediseve për zyrat rajonale zgjedhore të KQZ-së;

-Sigurimin e mjediseve të nevojshme për zhvillimin e programeve të trajnimit që KQZ-ja do të organizojë për komisionerët e KZQV-ve, dhe të kqV-ve, duke shfrytëzuar mjedise, në administrim të prefektëve ose të njëjësive përkatëse të qeverisjes vendore, sipas kalendarit të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

-Asistencë për shpërndarjen e bazës materiale zgjedhore dhe të fletëve të votimit për çdo KZQV;

-Nëpërmjet Ministrit të Mbrojtjes:

-Asistencë për transportin e bazës materiale zgjedhore dhe të fletëve të votimit në bashkitë dhe komunat e vendit, sipas grafikut të përcaktuar nga KQZ-ja.

-Vënien në dispozicion të KQZ-së, për nevoja emergjente, gjatë ditës së zgjedhjeve të një ose dy helikopterëve.

-Mbështetjen e KQZ-së me mjete të ndryshme transporti, në bazë të kërkesave të saj.

-Nëpërmjet Ministrit të Arsimit dhe Shkencës:

-Sigurimin e mjediseve të ndryshme, kryesisht, klasash mësimore dhe palestra shkollash për zhvillimin e seancave trajnuese me komisionerët zgjedhorë, si dhe zhvillimin e procesit të numërimit të votave.

-Nëpërmjet “Albtelecom” sh.a.-së:

-Asistencë për lidhjen me një linjë telefoni dhe faksi të zyrave të KZQV-se dhe vendeve të numërimit të votave në të gjithë vendin, duke mundësuar komunikimin e vazhdueshëm me KZQV-të, si dhe transmetimin e rezultateve paraprake.

KQZ-ja merr përsipër dhe i garanton Këshillit të Ministrave se:

-Në afatin e duhur do të nxjerrë aktet nënligjore, të detyrueshme për zbatimin nga organet jashtëzgjedhore.

-Do të identifikojë në nivel vendor mjediset e zyrave të KZQV-ve, vendeve të numërimit të votave, si dhe të mjediseve, që mund të shërbejnë për zhvillimin e seancave trajnuese.

-Do t'i sigurojë në kohë institucioneve të mësipërme të dhënat e duhura për realizimin e bashkëpunimit institucional, në funksion të administrimit të procesit zgjedhor.

Për respektimin e të drejtave dhe detyrimeve, që burojnë nga ky memorandum, palët veprojnë në bazë të kompetencave, që u njeh ligji. Në këtë kuadër, palët njohin rolin drejtues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në procesin e përgatitjes së zgjedhjeve, si dhe angazhimin e veçantë të strukturave të mësipërme, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ky memorandum bashkëpunimi hyn në fuqi në çastin e nënshkrimit nga palët dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë më 2006

## **VENDIM**

**Nr.711, datë 18.10.2006**

### **PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE TË SISTEMEVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika II, shkronja “a”, 10, pika 3.1, shkronjat “a” e “b” e 72, pika 5.1, shkronjat “a” e “b” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, dhe të neneve 3, shkronja “e”, 4,6, shkronja “a”, 7,8 e 16, pika 1 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Miratimin e transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 1, 2 e 3 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilave u transferohen pronat e paluajtshme të sistemeve përkatëse të ujësjellës-kanalizimeve, të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktore, kontratat e shërbimit dhe të koncesionit, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe njësive të qeverisjes vendore me donatorët e huaj dhe me shoqëritë kontraktuese.

3. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përfitojnë prona sipas lidhjeve 1, 2 e 3 të këtij vendimi, detyrohen të ruajnë statusin juridik të shoqërive anonime, që transferohen të paktën për një periudhë 2-vjeçare.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të pasqyrojë ndryshimet e kapitaleve, që vijnë si rezultat i transferimit të pronave të paluajtshme në njësitë e qeverisjes vendore, sipas lidhjeve 2 e 3.

5. Ngarkohen zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe njësitë e qeverisjes vendore të kryejnë procedurat e regjistrimit të pronave, të miratuara me këtë vendim.

6. Në çastin e transferimit në pronësi të njësive të qeverisjes vendore, të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të bëhet shlyerja e detyrimeve të vjetra ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në vlerën 71 540 (shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet) lekë, dhe ndaj Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, në vlerën 56 520 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet) lekë, përkatësisht, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Fondi prej 128 060 (njëqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëdhjetë) lekësh, për shlyerjen e detyrimeve të vjetra të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Brendshme, të transferojë në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore fonde me destinacion, subvencione dhe investimeve buxhetore për pronat e transferuara.

9. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1

**NDËRMARRJE TË UJËSJELLËSVE DHE TË KANALIZIMEVE, PRONAT E PALUAJTSHME SHTETËRORE TË TË CILAVE TRANSFEROHEN PLOTËSISHT**

Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
			VKM nr. ____, datë	Lista nr. __
Ujësjellës-kanalizime Krastë	sh.a.	Komuna Martanesh	251,24.4.2003	4

LIDHJA NR.2

**NDËRMARRJE TË UJËSJELLËSVE DHE TË KANALIZIMEVE, PRONAT E PALUAJTSHME SHTETËRORE TË TË CILAVE TRANSFEROHEN PLOTËSISHT SIPAS SISTEMEVE PËRBËRËSE**

Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Nr. e sistemeve që transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
				VKM nr. ____, datë	Lista nr. __
Ujësjellës Peqin	sh.a.	Bashkia Peqin	Sist.1	366,5.6.2003	16
Ujësjellës Kurbin	sh.a.	Komuna Mamurras	Sist.2,3,4	643,18.9.2003	4

**NDËRMARRJE TË UJËSJELLËSVE DHE TË KANALIZIMEVE, PRONAT E PALUAJTSHME SHTETËRORE TË TË CILAVE TRANSFEROHEN VETËM PËR SISTEMET PËRBËRËSE TË IDENTIFIKUARA**

Emërtimi i ndërmarrjes	Lloji	Njësia e qeverisjes vendore në të cilën transferohen	Nr. e sistemeve që transferohen	Referenca e miratimit të listave të inventarëve	
				VKM nr. ____, datë	Lista nr. __
Ujësjiellës Skrapar	sh.a.	Komuna Gjerbës	Sist.5,6	251,24.4.2003	13
		Komuna Vendereshë	Sist.12		
		Komuna Bogovë	Sist.3,4		
Ujësjiellës-kanalizime Krujë	sh.a.	Komuna Cudhi	Sist.3,4,6,7,8	643,18.9.2005	7
Ujësjiellës-kanalizime Elbasan	sh.a.	Komuna Gjinar	Sist.20	366,5.6.2003	5
Ujësjiellës-Tepelenë	sh.a.	Komuna Qesarat	Sist.14,15,22	643,18.9.2007	14

**VENDIM**

**Nr.721, datë 25.10.2006**

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE DISA FAMILJEVE TË DËMTUARA, RESPEKTIVISHT, NGA TËRMETET E DATAVE 6 E 8 GUSHT 2006 DHE 13 QERSHOR 2006, NË BASHKITË E KOMUNAT E QARQEVE VLORË E GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, dhe të neneve 31 dhe 32/a të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Njësive të mëposhtme të qeverisjes vendore në qarkun e Vlorës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:

a)Bashkisë së Himarës 3 046 312 (tre milionë e dyzet e gjashtë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, në ndihmë të familjeve të qytetit të Himarës, Himarë fshat, të fshatrave Pilur, Kudhës, Vuno dhe Qeparo, banesat e të cilave u dëmtuan nga tërmeti i dtave 6 e 8 gusht 2006. Shpërndarja e ndihmës financiare, sipas preventivave të përgatitura nga Këshilli i qarkut të Vlorës, të bëhet:

i) për familjet, banesat e të cilave kanë dëmtime të rënda, sipas shtojcës 1, tabela nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii)për familjet, banesat e të cilave kanë dëmtime më të lehta, sipas shtojcës 2, tabela nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b)Komunës Brataj 689 216 (gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, në ndihmë të familjeve të fshatrave Ramicë dhe Lepenicë, banesat e të cilave u dëmtuan nga tërmeti i datave 6 e 8 gusht 2006. Shpërndarja e ndihmës financiare të bëhet sipas shtojcës 1, tabela nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Komunës Lukovë 127 344 (njëqind e njëzet e shtetë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë, në ndihmë të familjeve të fshatrave Çoraj, Sasaj, Lukovë, Fterë dhe Borsh, banesat e të cilave u dëmtuan nga tërmeti i datave 6 e 8 gusht 2006. Shpërndarja e ndihmës financiare, sipas preventivave të vlerësimit të dëmeve, përgatitur nga këshilli i i qarkut të Vlorës, të bëhet:



i) për familjet, banesat e të cilave kanë dëmtime të rënda, sipas shtojcës 1, tabela nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii) për familjet, banesat e të cilave kanë dëmtime më të lehta, sipas shtojcës 2, tabela nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ç) Komunës Horë-Vranisht 91 336 (nëntëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, në ndihmë të familjeve të fshatrave Kuç e Vranisht, banesat e të cilave u dëmtuan nga tërmeti i datave 6 e 8 gusht 2006. Shpërndarja e ndihmës financiare sipas preventivave, përgatitur nga këshilli i qarkut të Vlorës, të bëhet sipas shtojcës 2, tabelat nr.3 dhe nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Komunës Qendër, Tepelenë, në qarkun e Gjirokastrës, në buxhetin e miratuar për vitin 2006, t'i shtohet fondi prej 2 903 000 (dy milionë e nëntëqind e tre mijë) lekësh, në ndihmë të familjeve të fshatit Luzat, banesat e të cilave u dëmtuan nga tërmeti i datës 13 qershor 2006. Shpërndarja e ndihmës financiare, sipas preventivëve, përgatitur nga këshilli i qarkut të Gjirokastrës, të bëhet:

i) për familjet, banesat e të cilave kanë dëmtime të rënda, sipas shtojcës 1, tabela nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii) për familjet, banesat e të cilave kanë dëmtime më të lehta, sipas shtojcës 2, tabela nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Fondi prej 6 857 208 (gjashtë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetë) lekë të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, dhe drejtuesit e bashkive dhe komunave, të përmendura në pikat 1 e 2, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ngarkohen prefektët e qarqeve Vlorë e Gjirokastrë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Familjet e dëmtuara rëndë  
Bashkia Himarë, Qarku Vlorë  
Fshati Pilur dhe fshati Kudhës

Shtojcë 1

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Kostandin	Çakalli	Pilur	297920
2	Thoma	Kabuci	Kudhës	323 600
3	Foto	Leka	Kudhës	45408
4	Arsen	Kabuci	Kudhës	600 000
5	Janaq	Tata	Kudhës	700 000
6	Napolon	Tata	Kudhës	600 000
7	Theodhori	Dhima	Himarë	48 000
8	Jorgji	Dhima	Himarë	48 000
	Shuma			266 29 28

Tabela nr.2  
Komuna Brataj Qarku Vlorë  
Fshati Lepenicë dhe Ramicë

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Namik	Rexhepaj	Lepenicë	612 400
2	Nexhmije	Pronjaj	Ramicë	76816
3	Shuma			689216

Tabela nr.3  
Komuna Lukovë, Qarku Vlorë  
Fshati Çorraj

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Llavidh	Duka	Çorraj	52 000
2	Shuma			52 000

Tabela nr.4  
Komuna Qendër Tepelenë, Qarku Gjirokastrë  
Fshati Luzat

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Masa e ndihmës në lekë
1	Rexho	Bajram	Qibina	151 000
2	Tafil	Bajram	Qibina	151 000
3	Bajre	Teme	Xhana	138 000
4	Qemal	Kamber	Dedgjoni	227 000
5	Platon	Rushit	Kopella	177 000
6	Gazmir	Banush	Buqi	77 000
7	Luan	Medi	Dena	219 000
8	Hysen	Telha	Satrofli	163 000
	Shuma			130 3000

Shtojcë nr.2  
Familje me dëmtime të lehta deri në të mesme  
Bashkia Himarë, Qarku Vlorë  
Qyteti Himarë dhe Himara fshat, fshati Vuno, Qeparo  
Pilur dhe Kudhës

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/Qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Pano (Llazar)	Kuli	Himarë dhe Himara Fshat	720
2	Fotina	Skura	Himarë dhe Himara Fshat	3840
3	Eftihi	Dhima	Himarë dhe Himara Fshat	1920
4	Marko	Dhimojani	Himarë dhe Himara Fshat	3840
5	Afroviti	Dhimojani	Himarë dhe Himara Fshat	960
6	Spiro	Dhimojani	Himarë dhe Himara Fshat	2080
7	Andon	Kokaveshi	Himarë dhe Himara Fshat	1920
8	Adriana	Kokaveshi	Himarë dhe Himara Fshat	1200
9	Klearko	Kokaveshi	Himarë dhe Himara Fshat	2880

10	Antonia	Gjika	Himarë dhe Himara Fshat	1200
11	Melpomeni	Gjezo	Himarë dhe Himara Fshat	2880
12	Napolon	Karo	Himarë dhe Himara Fshat	1000
13	Vasil	Karo	Himarë dhe Himara Fshat	1000
14	Ciko	Karo	Himarë dhe Himara Fshat	1600
15	Milo	Karo	Himarë dhe Himara Fshat	1600
16	Nikolla	Gjinuci	Himarë dhe Himara Fshat	2400
17	Savo	Mato	Himarë dhe Himara Fshat	960
18	Vangjel	Karo	Himarë dhe Himara Fshat	5760
19	Petro	Zisi	Himarë dhe Himara Fshat	1440
20	Ilia	Zisi	Himarë dhe Himara Fshat	960
21	Othana	Bollano	Himarë dhe Himara Fshat	3840
22	Petro	Milo	Himarë dhe Himara Fshat	2400
23	Katerina	Dhimogjoka	Himarë dhe Himara Fshat	1440
24	Ilia	Gjezo	Himarë dhe Himara Fshat	1440
25	Thoma	Nerenxi	Himarë dhe Himara Fshat	960
26	Dhimitraq	Bollano	Himarë dhe Himara Fshat	4800
27	Dhimitër	Zoto	Himarë dhe Himara Fshat	2880
28	Mano	Likoka	Himarë dhe Himara Fshat	960
29	Thanas	Konomi	Himarë dhe Himara Fshat	960
30	Kozma	Luli	Himarë dhe Himara Fshat	2880
31	Stefan (Perikli)	Andoni	Vuno	2400
32	Augusta	Çamoro	Vuno	6400
33	Spiro	Lami	Qeparo	960
34	Kleo	Lani	Qeparo	30720
35	Janaq	Polo	Qeparo	3840
36	Aleks	Qesari	Qeparo	3440
37	Spiro	Dhimuci	Qeparo	2640
38	Simo	Kongjini	Pilur	540
39	Minella	Kongjini	Pilur	720
40	Ndreko	Lapa	Pilur	3240
41	Pinjo	Gerdhuqi	Pilur	1800
42	Athina	Prifti	Pilur	1260
43	Janaq	Lapa	Pilur	720
44	Edmond	Prifti	Pilur	360
45	Nine	Boci	Pilur	900
46	Llambro	Bala	Pilur	360
47	Polo	Boci	Pilur	720
48	Arqile	Lapa	Pilur	720
49	Kola	Kolagji	Pilur	1440
50	Kozma	Lapa	Pilur	1080
51	Milto	Kolagji	Pilur	720
52	Piro	Merkuri	Pilur	3600
53	Koço	Merkuri	Pilur	3840
54	Stavro	Merkuri	Pilur	2880
55	Koni	Gerdhuqi	Pilur	2160
56	Hajro	Çipa	Pilur	360
57	Andon	Çipa	Pilur	1080
58	Andon	Kongjini	Pilur	1080
59	Eftiqi	Boci	Pilur	17920

60	Zaho	Prifti	Pilur	720
61	Andrea	Gerdhuqi	Pilur	360
62	Milto	Koka	Pilur	720
63	Dhimo	Koka	Pilur	1080
64	Sofo	Çipa	Pilur	4240
65	Irakli	Çipa	Pilur	6280
66	Piro	Koka	Pilur	900
67	Milto	Çakalli	Pilur	1440
68	Simo	Kongjini	Pilur	11200
69	Lluka	Kongjini	Pilur	1080
70	Aristidh	Lapa	Pilur	2580
71	Vasil	Merkuri	Pilur	360
72	Pavlo (K)	Bala	Pilur	720
73	Pilo	Kongjini	Pilur	720
74	Qirjako	Bala	Pilur	360
75	Margarit	Kongjini	Pilur	7200
76	Jorgo	Bala	Pilur	2320
77	Simo	Bala	Pilur	2040
78	Odise	Merkuri	Pilur	360
79	Odise	Markolli	Pilur	600
80	Lilo	Merkuri	Pilur	360
81	Pavlo	Bala	Pilur	1032
82	Savo	Gerdhuqi	Pilur	1416
83	Vangjel	Merkuri	Pilur	1200
84	Vasil	Merkuri	Pilur	10560
85	Vasil	Lapa	Pilur	26800
86	Gaqo	Bala	Pilur	1536
87	Kiço	Prifti	Pilur	1320
88	Milto	Gjicali	Pilur	7200
89	Llabro	Prifti	Pilur	1400
90	Fato	Kreko	Pilur	26000
91	Vasil	Merkuri	Pilur	1272
92	Jani	Kreku	Pilur	1200
93	Thoma	Merkuri	Pilur	1400
94	Zaro	Merkuri	Pilur	1320
95	Sini	Bala	Pilur	1200
96	Qirjako	Dedi	Kudhës	1980
97	Gligor	Leka	Kudhës	1800
98	Jorgo	Kabuci	Kudhës	1080
99	Fotina	Leka	Kudhës	2160
100	Thanas	Noti	Kudhës	720
101	Minella	Noti	Kudhës	1800
102	Ligor	Jovani	Kudhës	1800
103	Thoma	Kushta	Kudhës	720
104	Sofo	Kushta	Kudhës	1080
105	Llambro	Gjikhuri	Kudhës	720
106	Milto	Kabuci	Kudhës	2160
107	Filip	Kabuci	Kudhës	1080
108	Ardo	Memi	Kudhës	3240
109	Leonidha	Gjini	Kudhës	1440

110	Foto	Kabuci	Kudhës	10800
111	Pavillo	Gjini	Kudhës	7200
112	Kosta	Gjini	Kudhës	2520
113	Qirjako	Dedi	Kudhës	540
114	Marija	Kushta	Kudhës	1620
115	Eftiqi	Mertiri	Kudhës	2520
116	Thull	Mertiri	Kudhës	540
117	Thoma (Zako)	Çani	Kudhës	1080
118	Llambro	Tata	Kudhës	2160
119	Nil	Dedi	Kudhës	6480
120	Harillo	Nini	Kudhës	2520
121	Dhimitër	Tata	Kudhës	2880
122	Lefter	Dhima	Kudhës	1620
123	Petro	Dhima	Kudhës	1440
124	Niqe	Kushta	Kudhës	1440
125	Lek	Leka	Kudhës	1620
126	Thoma (Çane)	Çani	Kudhës	3600
127	Arqile	Tata	Kudhës	2520
128	Thanas	Velçi	Kudhës	2880
129	Irakli	Jovani	Kudhës	2880
130	Naqe	Leka	Kudhës	3240
131	Qirjako	Naqi	Kudhës	1080
132	Andrea	Fllori	Kudhës	1440
133	Mevlan	Bushi	Kudhës	900
134	Aristir	Paskali	Kudhës	2160
135	Milto	Nini	Kudhës	648
136	Nikit	Çani	Kudhës	1440
137	Aleks	Dedi	Kudhës	720
	Shuma			383384

Tabela nr.2  
Komuna Lukovë  
Fshatrat Çorraj, Lukovë, Fterë dhe Borsh

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Melipo	Koka	Çorraj	2400
2	Jorgo	Duka	Çorraj	3600
3	Isuf	Aliko	Çorraj	2880
4	Habib	Hitaj	Çorraj	960
5	Spiro	Dhrami	Çorraj	2880
6	Vasil	Dhrami	Çorraj	2880
7	Meto	Balili	Sasaj	1920
8	Avdul	Shehu	Lukovë	1920
9	Çuman	Brinja	Fterrë	2880
10	Hamza	Mehmeti	Fterrë	3840
11	Sulo	Zani	Fterë	1920
12	Myzafer	Rroku	Borsh	25344
13	Landro	Hodo	Borsh	14560
14	Agron	Bizhga	Borsh	7360
	Shuma			75344

Tabela nr.3  
Komuna Horë Vranisht, Qarku Vlorë  
Fshati Kuç

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Selman	Gjologaj	Kuç	7440
2	Namik	Zenelaj	Kuç	1620
3	Dervish	Zenalaj	Kuç	900
4	Mustafa	Goxhaj	Kuç	1080
5	Malo	Toçaj	Kuç	1800
6	Zydi	Goxhaj	Kuç	3240
7	Reiz	Thomaraj	Kuç	9900
8	Ramiz	Thomaraj	Kuç	540
9	Reshat	Brahimaj	Kuç	3456
10	Gastere	Saliaj	Kuç	1440
11	Pajtim	Jonuzaj	Kuç	1080
12	Rrapo	Balilaj	Kuç	25020
13	Avni	Balilaj	Kuç	1080
14	Ferdinand	Lalaj	Kuç	720
15	Vilson	Lalaj	Kuç	720
16	Koço	Denaj	Kuç	1080
17	Avni	Bajaj	Kuç	4480
18	Agim	Lamaj	Kuç	1080
19	Lame	Idrizaj	Kuç	540
20	Goxho	Boraj	Kuç	360
	Shuma			67576

Tabela nr.4  
 Komuna Horë, Vranisht, Qarku Vlorë  
 Fshati Vranisht

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Sabri	Kongjoni	Vranisht	900
2	Birçe	Meta	Vranisht	540
3	Sokrat	Lloi	Vranisht	360
4	Selvi	Lloi	Vranisht	360
5	Spiro	Lima	Vranisht	360
6	Tasim	Shkurti	Vranisht	540
7	Elham	Qorri	Vranisht	540
8	Zihni	Janushi	Vranisht	360
9	Avdul	Qorri	Vranisht	540
10	Ethem	Shkurti	Vranisht	2160
11	Aliko	Shkurti	Vranisht	360
12	Dodo	Feruni	Vranisht	2160
13	Enver	Gjoleka	Vranisht	1260
14	Alush	Cenodemaj	Vranisht	1080
15	Ismail	Shehu	Vranisht	1800
16	Maks	Kongjini	Vranisht	1080
17	Jaho	Kongjini	Vranisht	720
18	Ferdinand	Bejko	Vranisht	720
19	Elez	Shkurti	Vranisht	540
20	Veliko	Laba	Vranisht	540
21	Xhemil	Ibro	Vranisht	540
22	Çerçiz	Shkurti	Vranisht	360
23	Naze	Haliko	Vranisht	360
24	Pajtim	Aliko	Vranisht	900
25	Nimet	Limaj	Vranisht	720
26	Petrit	Mici	Vranisht	900
27	Maks	Mehmeti	Vranisht	1440
28	Halit	Cacaj	Vranisht	1620
	Shuma			23760

Tabela nr.5  
Komuna Qendër, Tepelenë, Qarku Gjirokastrë  
Fshati Luzat

Nr	Emri	Mbiemri	Fshati/qyteti	Masa e ndihmës në lekë
1	Feim	Qibini	Luzat	40 000
2	Anastas	Meshini	Luzat	40 000
3	Hanushe	Qibini	Luzat	40 000
4	Qamil	Bodeci	Luzat	40 000
5	Iilir	Bideci	Luzat	40 000
6	Shaban	Buça	Luzat	40 000
7	Viktor	Çaka	Luzat	40 000
8	Syrja	Çaka	Luzat	40 000
9	Ylli	Çaka	Luzat	40 000
10	Flamur	Alia	Luzat	40 000
11	Luiza	Muça	Luzat	40 000
12	Agron	Kopaçi	Luzat	40 000
13	Muharrem	Muçi	Luzat	40 000
14	Bujar	Alia	Luzat	40 000
15	Dervish	Guma	Luzat	40 000
16	Shermet	Guma	Luzat	40 000
17	Skënder	Qibini	Luzat	40 000
18	Halo	Dena	Luzat	40 000
19	Isa	Kopaçi	Luzat	40 000
20	Perlat	Shatrafil	Luzat	40 000
21	Sylfie	Kamberi	Luzat	40 000
22	Limos	Koçi	Luzat	40 000
23	Mysybe	Malo	Luzat	40 000
24	Alime	Gjyli	Luzat	40 000
25	Bardhul	Rodi	Luzat	40 000
26	Qazim	Shatrafil	Luzat	40 000
27	Kasem	Xhima	Luzat	40 000
28	Shyqo	Koçi	Luzat	40 000
29	Selaudin	Guma	Luzat	40 000
30	Shkëlqim	Rodi	Luzat	40 000
31	Bashkim	Shatrafil	Luzat	40 000
32	Haxho	Gaxha	Luzat	40 000
33	Metat	Boni	Luzat	40 000
34	Bejo	Alia	Luzat	40 000
35	Sadat	Guma	Luzat	40 000
36	Tahir	Qibini	Luzat	40 000
37	Rahim	Dena	Luzat	40 000
38	Luan	Musaraj	Luzat	40 000
39	Xhevat	Progonati	Luzat	40 000
40	Hamza	Karafili	Luzat	40 000
	Shuma			1600000



**VENDIM**  
**Nr.724, datë 1.11.2006**

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË KOMPANISË  
TEATRORE SHETËRORE TË ARTIT DRAMATIK (TEATRI KOMBËTAR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr.8578, datë 10.2.2000 “Për teatrin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Z.Armand Bora, drejtor i Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar), lirohet nga kjo detyrë.

2.Z.Kristaq Skrami emërohet drejtor i Kompanisë Teatrore Shtetërore të Artit Dramatik (Teatri Kombëtar).

3.Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.731, datë 1.11.2006**

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “PËR MUNDËSINË E NDËRTIMIT TË TERMINALEVE  
TË GAZIT NATYROR TË LËNGËZUAR (GNL) DHE TË INFRASTRUKTURËS  
PËRKATËSE, NË BREGDETIN E QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e studimit “Për mundësinë e ndërtimit të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe të infrastrukturës përkatëse, në bregdetin e qarkut të Fierit”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për zonat e përcaktuara në studim, për ndërtimin e terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me organet përkatëse të njësive të qeverisjes vendore, të përgatisin masterplanin për terminalët dhe për infrastrukturën përkatëse, tokësore dhe detare. Për hapësirat e paraqitura në studim të fillojnë procedurat ligjore për shqyrtimin e tyre edhe në zbatim të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar.

Paraqitja e masterplanit për shqyrtim në KRRTRSH të bëhet brenda datës 20.12.2006.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.737, datë 1.11.2006**

**PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor, parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1.Nxënësit dhe studentët mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, nga buxheti vjetor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2.Nxënësit dhe studentët përfitojnë bursë, brenda kuotave të përcaktuara në këtë vendim në bazë të:

A.Kriterit ekonomik, kur:

a)vazhdojnë studimet larg vendbanimit të tyre dhe plotësojnë kriterin ekonomik e vendosen në konvikte publike, sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

b)banojnë në fshatra, që nuk kanë shkollë 9-vjeçare, brenda rrezes prej 5 km, e vendosen në konvikt publik;

c)kanë përfituar statusin e jetimit dhe plotësojnë kriterin ekonomik;

ç)kanë humbur kujdestarinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë, dhe plotësojnë kriterin ekonomik;

d)secili nga studentët bashkëshort, që ka fëmijë, plotëson kriterin ekonomik dhe vendoset në konvikt publik;

dh)janë fëmijë të punonjësve të policisë, që kanë humbur jetën në krye e për shkak të detyrës;

e) janë fëmijë të ushtarakut, që ka humbur jetën në detyrë ose për shkak të detyrës.

B.Rezultateve të arritura:

a)nxënësit e arsimit të mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me të gjitha notat 10-ta;

b)studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë, që kanë mbaruar shkollën e mesme me medalje të artë, numri i të cilëve për vitin 2006 është 3 (tre);

c)studentët, që regjistrohen në vitin e parë të shkollës së lartë e që janë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më të mirët e Maturës Shtetërore, numri i të cilëve për vitin 2006 është 27 (njëzet e shtatë);

ç) studentët që kanë mbaruar vitin akademik paraardhës me të gjitha notat 10-ta;

e)studentët, që vazhdojnë studimet në degët matematikë dhe fizikë e, që pas përfundimit të plotë të vitit të parë, arrijnë notën mesatare mbi 8-të.

3.Nxënësit dhe studentët e humbasin të drejtën e përfitimit të bursës, kur:

a)janë ndarë nga trangu familjar;

b)familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c)humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jokaluese;

ç)vazhdojnë studimet për degë të dytë.

4.Ministria e Arsimit dhe Shkencës harton planin e shpërndarjes së bursave, sipas kuotave të miratuara, në nivel rrethi, për nxënësit dhe studentët, si më poshtë vijon:

a) Drejtoritë arsimore rajonale (DAR) dhe zyrat arsimore (ZA), pas këshillimit me strukturat e pushtetit vendor, bëjnë planin e shpërndarjes së bursave në bashki dhe komuna, në përshtatje me kërkesat e paraqitura, paraprakisht, prej tyre për nxënësit e studentët e përcaktuar në shkronjën "A" të pikës 2.

b) Shkollat e larta paraqesin kërkesat për studentët, që përfitojnë bursë, sipas shkronjës "B" të pikës 2 në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila harton planin e shpërndarjes dhe ia dërgon për ekzekutim shkollave të larta.

5. Bashkitë dhe komunat, në bazë të planit të përcaktuar për to, vendosin, në bashkëpunim me këshillat, dhënien e bursave, sipas kriterit ekonomik, të përcaktuar në këtë vendim, duke iu dhënë përparësi nxënësve dhe studentëve më në nevojë, për trajtim me bursë të plotë ose, në pamundësi, edhe në gjysmëbursë:

a) Bashkitë dhe komunat, detyrimisht, duhet t'u dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorive arsimore rajonale apo zyrave arsimore përkatëse vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokuentacionin përkatës.

b) Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore duhet të dërgojnë pranë shkollave, parauniversitare apo të larta, përkatëse, listën emërore të nxënësve dhe të studentëve, që do të përfitojnë bursë, së bashku me vendimet origjinale të këshillave të bashkive dhe/ose të komunave. Një kopje e listës emërore dërgohet edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

6. Bursat për vitet e dyta e lart rishqyrtohen, për çdo vit, nga shkollat parauniversitare apo të larta, përkatëse dhe miratohen nga vetë ato. Studentët e viteve të dyta e lart, që nuk kanë përfituar bursë dhe plotësojnë kriterin ekonomik, mund të përfitojnë bursë, brenda planit të bursave të vitit të parë. Numri i bursave për këtë kategori studentësh dhe për studentët, që përfitojnë bursë sipas pikës 2.B është deri në 130, në shkallë vendi, brenda numrit të përgjithshëm të bursave, të dhëna për vitin 2006-2007. Plani i shpërndarjes së tyre bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Nxënësit dhe studentët, që kanë përfituar bursë gjatë vitit të parë me vendim të këshillit të bashkisë apo komunës, e marrin këtë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit, nëse atyre nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike.

7. Bursat për studentët administrohen nga shkollat e larta dhe u jepen çdo muaj, me kalim në llogarinë bankare të çdo studenti. Bursat për nxënësit administrohen, sipas rastit, nga drejtoritë e konvikteve apo drejtoritë e shkollave dhe u jepen nxënësve vetëm me ushqim në konvikt.

8. Nxënësit dhe studentët, që vijnë nga shtëpitë e fëmijës, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përfitojnë falas veshmbathjen, libra, fletore etj., sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Këta nxënës apo studentë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë shkollat.

9. Nxënësve dhe studentëve jetimë u sigurohen falas, nga fondet e shkollave përkatëse, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet, pas paraqitjes së librezës dhe të kartelës shëndetësore, si dhe të epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

Nxënësit jetimë e përfitojnë bursën edhe gjatë pushimeve verore, si dhe vetëm 1 vit, kur humbasin vitin shkollor, për arsye të rezultateve jokalueuse.

Fëmijët dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqimi (drekë), me vlerë deri në 100 (njëqind) lekë në ditë.

10. Niveli i bursës për nxënësit dhe studentët jepet sipas pasqyrave nr.3 dhe nr.4 dhe kuota financiare ushqimore ditore jepet sipas pasqyrave nr.5 dhe nr.6, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

11. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 2006-2007, i jepen 900 bursa për arsimin e mesëm dhe 900 bursa për arsimin e lartë, për të gjitha kategoritë e parashikuara në pikën 2, shkronjat "A" dhe "B".

12. Efektet financiare, për vitin shkollor 2006-2007, të përballohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, përkatësisht nga buxheti i vitit 2006, për pjesën e vitit 2006, dhe nga buxheti që do të miratohet për vitin 2007, për pjesën e vitit 2007.

13. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave, për vitet e para, është data 15 dhjetor 2006, për të gjitha kategoritë e shkollave, ndërsa për vitet e dyta e lart është data 15 nëntor 2006.

14.Vendimi nr.688, datë 26.10.2005 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike”, shfuqizohet.

15.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore në rrethe, shkollat përkatëse, parauniversitare dhe të larta, si dhe të gjitha bashkitë dhe komunat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS  
(Viti mësimor 2006-2007)

Pasqyra nr.1

Të ardhurat për frymë

Nr.	Përbërja familjare	Bursa	Gjysmëbursa	Me pagesë
	Për qytetin			
1	Për familjet me 2 persona	1700	1700-2850	Mbi 2850
2	Për familjet me 3 persona	1500	1500-2550	Mbi 2550
3	Për familjet me 4 persona	1400	1400-2450	Mbi 2450
4	Për familjet me 5 persona	1300	1300-2350	Mbi 2350
5	Për familjet me 6 persona	1200	1200-2250	Mbi 2250
6	Për familjet me 7 persona	1100	1100-2150	Mbi 2150
7	Për familjet me 8 persona	1000	1000-2050	Mbi 2050

Shënim:Nxënësit nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70% të bursës së plotë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme.

KUSHTET EKONOMIKE TË STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS  
(Viti mësimor 2006-2007)

Të ardhurat për frymë

Pasqyra nr.2

Nr.	Përbërja familjare	Bursa	Gjysëm bursa	Me pagesë
	Për qytetin			
1	Për familjet me 2 persona	2050	2050-3300	Mbi 3300
2	Për familjet me 3 persona	1850	1850-3100	Mbi 3100
3	Për familjet me 4 persona	1750	1750-3000	Mbi 3000
4	Për familjet me 5 persona	1650	1650-2900	Mbi 2900
5	Për familjet me 6 persona	1550	1550-2800	Mbi 2800
6	Për familjet me 7 persona	1450	1450-2700	Mbi 2700
7	Për familjet me 8 persona	1350	1350-2600	Mbi 2600

Shënim:Studentët nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja përfiton ndihma ekonomike të plotë dhe 70% të bursës së plotë, kur familja përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme.

NIVELI I BURSËS PËR NXËNËSIT  
(Viti mësimor 2006-2007)

Pasqyra nr.3  
Në lekë

Nr.	Kategoritë e nxënësve sipas shkollave	Bursat dhe pagesat e nxënësit	Financimi nga shteti	Financimi nga nxënësit	Për ushqim	Shpenzime vetjake
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	Bursa	5000	5000		4800	200
	Gjysmëbursa	5000	2500	2500	4800	200
	Me pagesë	5000		5000	4800	200
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive dhe nxënësit e arsimit special					
	Bursa	5500	5500		5300	200
	Gjysmëbursa	5500	2750	2750	5300	200
	Me pagesë	5500		550	5300	200
3	Nxënësit jetim	5500	5500		5300	200

NIVELI I BURSËS PËR STUDENTËT  
(Viti mësimor 2006-2007)

Pasqyra nr.4  
Në lekë

Nr.	Kategoritë studentëve sipas shkollave	Bursat dhe pagesat e studentëve	Financimi nga shteti	Financimi nga studenti	Kuota e ushqim	Kuota e fjetjes
1	Universitetet, Akademia e Arteve dhe Shkolla e Lartë e Infermierisë					
	Bursa	8000	8000		6500	1500
	Gjysmëbursa	8000	4000	4000	6500	1500
	Me pagesë	8000		8000	6500	1500
2	Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve					
	Bursa	8500	8500		7000	1500
	Gjysmëbursa	8500	4250	4250	7000	1500
3	Me pagesë	8500		8500	7000	1500

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE**  
(Viti mësimor 2006-2007)

Pasqyra nr.5

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera
1	Bukë	Gram	400	1117	55	22
2	Makarona	“	30	107	80	2.4
3	Oriz	“	30	109	70	2.1
4	Sheqer	“	40	157	60	2.4
5	Fasule	“	30	93	150	4.6
6	Perime	“	130	27	70	9.2
7	Fruta	“	100	42	100	10
8	Vaj	“	30	270	170	5.1
9	Gjalpë	“	20	152	500	10
10	Mish	“	90	130	550	49.5
11	Djath	“	25	40	350	8.75
12	Reçel	“	20	93	250	5
13	Veze	Kokërr	1	42	10	10
14	Qumësht	“	200	98	20	4
15	Patate	Gram	200	170	50	10
16	Nënprodukte mishi	“	30	100	300	9
	Kuota ditore			2746		164

Shënim: Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojë sipas menuve të ndryshme, sipas çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e prokurimeve dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

**KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E STUDENTËVE**  
(Viti mësimor 2006-2007)

Pasqyra nr.6

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar	Vlera
1	Bukë	Gram	600	1675	55	33
2	Makarona	“	40	143	80	3.2
3	Oriz	“	40	145	70	2.8
4	Sheqer	“	80	314	60	4.8
5	Fasule	“	40	124	150	6
6	Perime	“	200	41	70	14
7	Fruta	“	100	42	100	10
8	Vaj	“	40	360	170	6.8
9	Gjalpë	“	20	152	500	10
10	Mish	“	100	144	550	55
11	Djath	“	40	64	350	14
12	Reçel	“	44	92	250	11
13	Veze	Kokërr	300	255	50	15
14	Qumësht	“	300	147	20	6
15	Patate	Gram	1	93	10	10
16	Nënprodukte mishi	“	50	167	300	15
	Kuota ditore			3958		216.6

**KUOTA FINANCIARE TË VESHMBATHJES**  
(Viti mësimor 2006-2007)

Pasqyra nr.7

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7000
2	Për jetimët	10 000

**VENDIM**  
**Nr.749, datë 9.11.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.711, DATË 27.12.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT DHE KUVENDIT DHE DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.39, DATË 26.1.2001, NR.158, DATË 22.3.2001, NR.167, DATË 30.3.2001, NR.174, DATË 30.3.2001, NR.197, DATË 6.4.2001, NR.358, DATË 31.5.2001 DHE NR.424, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 6/1 të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.3 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin, numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2006.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.3

**KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS**

<b>Institucioni</b>	<b>Pozicioni</b>	<b>Kategoria e pagës</b>
<b>Kryeministria</b>	Drejtor i Njësisë së Zbatimit të Projekteve të Bankës Botërore	II-a
	Jurist në Departamentin e Legjislacionit, Koordinimit&Dokumentacionit	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ&Antikorrupsionit	II-b
	Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive&Koordinimit të Ndhmës së Huaj	II-b
	Koordinator në Departamentin e Legalizimit&Formalizimit të Ekonomisë Ekstraligjore	II-b
	Drejtor i Njësisë së Teknologjisë së Informacionit dhe e Government	II-a



Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues Ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	Kryeinspektor i Inspektoratit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministria e Brendshme	Drejtor i Njësisë Antitrafik	II-a
	Përgjegjës Sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Njësinë Antitrafik	III-a
Ministritë e linjës	Inspektor në Drejtoritë e Auditimit të Brendshëm, apo sektorët e auditimit të brendshëm	III-a
		III-b

**VENDIM**  
**Nr.750, datë 9.11.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.198,DATË 5.4.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PRANIMET NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT E LARTA, PËR VITIN AKADEMIK 2006-2007, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË, DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.198, datë 5.4.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

a) Fjalja e dytë e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Masa e tarifës së shkollimit, për studentët, që ndjekin studimet në degë të dytë, të përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave.”.

b) Pas pikës 10 të shtohen pikat 10.1 dhe 10.2, me këtë përmbajtje:

“10.1. Studentët, që ndjekin studimet, sipas fakulteteve dhe degëve përkatëse, me kuota dytësore, të përjashtohen, në të gjitha vitet e shkollimit, nga tarifa e veçantë e shkollimit.

10.2. Tarifa e shkollimit, e përcaktuar për kuotën e pranimit, për studentët, të cilët janë regjistruar me kuota dytësore, në fakultete dhe degë të ndryshme të shkollave të larta, përpara vitit akademik 2006-2007, të reduktohet në masën e kuotës kryesore.”.

c) Pika 11 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, e cila duhet të jetë tarifë shkollimi me kuota kryesore ose me degë të dytë. Studentët përsëritës i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, me kuota kryesore ose me degë të dytë të vitit akademik 2006-2007.”.

ç) Pika 13 të ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Studentët, që kërkojnë të transferojnë studimet nga arsimit i lartë jopublik, në arsimin e lartë publik, brenda sistemit tonë të arsimit të lartë (vite të ndërmjetme), si dhe ata nga jashtë Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen tarifës së shkollimit të barabartë me tarifën e kuotave kryesore, duke filluar nga viti akademik 2006-2007.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga ndryshimi i tarifës së shkollimit, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT  
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë